REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER RIDVANA G. RUÇI
ADRESA KAJO KARAFILI
TEL: 683030361

# KONTRATA TË TJERA

**Nr. repertori: 1376** **Nr. koleksioni: 585**

**Tirane më 02/03/2023**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A20230532400061749832

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë

A2023053240061749832

# KONTRATË BASHKIMI I PERKOHSHEM I SHOQERIVE

Sot, më datë 02. 03. 2023 , para meje Notere RIDVANA G. RUÇI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, KAJO KARAFILI, u paraqit personalisht:

**PALA 1**:Shoqëria 2B 1979, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L91508021H, me adresë Rruga Ismail Qemali,34, Hyrja Nr 1, Kati 1, përfaqësuar nga Administratori Bledar Broshka, atësia Bajram, amësia Tushe, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë E Dibrës; Nd. 10; H. 5; Ap. 21; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 03/04/1979, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035720512 dhe nr. personal H90403155N.

**PALA 2**:Shoqëria 2 T, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K01731001M, me adresë Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 4, Ap. 5, përfaqësuar nga Administratori Artan Sako, atësia Sadik, amësia Meafte, shtetas Shqiptar, lindur në Nivicë, Tepelenë dhe banues në Tiranë, me adresë Frosina Plaku; Nd. 38; H. 1; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 30/05/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034080337 dhe nr. personal H20530054L.

**Rrethanat e hartimit të aktit noterial:**

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate bashkëpunimi dhe keto dy shoqeri do te referohen si pale te kesaj kontrate. Unë noterja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

## Baza Ligjore

- Neni 659 e vijues të Kodit Civil
- Ligji nr. 9901, datë 14.08.2009 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar
- Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 *"Për Noterinë"*
- **Neni 44, pika 2, neni 46, pika 1, gërma "ç" të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar**

## Neni 1
## Përshkrimi i objektit

Objekti i kësaj kontrate është krijimi i një marrëdhënie bashkëpunimi te perkohshem mes shoqërive per zbatimin e objektit:

Ndertimin e impiantit gjenerues te energjise elektrike fotovoltaike me kapacitet te instaluar 2 MW dhe veprave ndihmese.

A2023053240061749832

Autoritet Kontraktor : MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE

Duke qene se paleve te mesiperme u eshte dhene leja Miratim per Ndertim me objekt "*Ndertimin e impiantit gjenerues te energjise elektrike fotovoltaike me kapacitet te instaluar 2MW, dhe veprave ndihmese*, marrin persiper kryerjen e punimeve sipas specifikimeve teknike te vendosura nga Autoriteti Kontraktor.

Palet vendosin qe ky Bashkim i Perkohshem i Shoqerive do te regjistrohet ne QKB me NUIS perkates si "Joint Venture". Pas regjistrimit me NUIS perkates do te hapet nje llogari e perbashket ne nje Bankat e Nivelit te Dyte qe operojne ne Republiken e Shqiperise, nen emrin e Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive.

Emri do te jete "**Joint Venture 2B1979 dhe 2T shpk**" .
Bashkimi i Operatoreve do te paraqese prane Autoritetit Kontraktor situacionin pjesor te shoqeruar me faturen perkatese dhe Likujdimet e faturave do te kryhen ne llogarine bankare te Joint Venture 2B 1979 shpk dhe 2T shpk.
Secili operator do te paraqese prane "Joint Venture" situacionin pjesor sipas perqindjeve te caktuara, te shoqeruara me faturen perkatese. Likujdimi i ketyre faturave do te kryhet ne llogarine e seciles shoqeri nga llogaria e Joint Venture.

Kapitali i shoqerise eshte 1000 (nje mije) Leke, i barabarte me 2 (dy) kuota. Kontributet e ortakeve perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Pjesmarrja e ortakeve ne kapitalin e shoqerise eshte ne raport me kontributin e derdhur prej tij, dhe vlera nominale e kuotes te secilit ortak, llogaritet ne raport me secilin kontribut, paraqitur ne menyre te permbledhur sipas grafikut te meposhtem:

| Nr. | Ortaket | Kuota | Kontributi i ortakeve ne kapital | Perqindja ne kapital |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Shoqeria 2 B1979 shpk | 1 | 500 | 50% |
| 2 | Shoqeria 2T shpk | 1 | 500 | 50% |
| Totali | 2 | 2 | 1000 | 100 % |

Kontributet sa me siper, jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana ortakeve te shoqerise.

## Neni 2
## Qellimi

Kryerja e punimeve te ndertimit dhe furnizimit sipas zerave te preventivit fitues te objektit "Pjesemarrje ne proceduren e miratimit te ndertimit te kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike qe nuk jane objekt koncesion"

Shoqeria 2B 1979 shpk dhe 2T shpk, bien dakord qe te bashkojne forcat dhe kompetencat e tyre ne kuadrin e nje bashkepunimi te perkohshem ne nje grup te vetem (referuar me poshte si "grupi")

Ky bashkepunim eshte ekskluziv dhe reciprok, dhe secila pale merr persiper konfidencialitetin e ketij bashkepunimi si dhe mos bashkimin me asnje pale te trete.

A2023053240061749832

## Neni 3
## Perfaqesimi i Kontrates

Bashkimi i Perkohshem i Shoqerive ne perputhje me kete Kontrate, do te perfaqesohet nga Elian Shena i biri i Syrjait, me dtl 28.04.1991 lindur ne Progonat, Tepelene, e banues ne Tiranë, pajisur me karten e identitetit me nr personal: J10428140 M

**i cili do te kete statusin e Administratorit te vetem te Joint Venture "2B 1979" dhe "2T" shpk.**

**Afati I emerimit te administratorit do te jete 5 (pese) Vjet .**

**Selia e shoqerise do te jete ne adresen:Rruga Asim Vokshi, Nd 14, H4, Ap 5 Tirane.**

Perfaqesuesi do te perfaqesoje shoqerite ne lidhje me zbatimin e Lejes "Miratim per Ndertim" Per ndertimin e impiantit gjenerues te energjise elektrike fotovoltaike me kapacitet te instaluar 2MW, dhe veprave ndihmese ne zonen Grykë, Bashkia Fier, Qarku Fier"

Ai ka te drejte gjithashtu te nenshkruaje dhe depozitoje te gjitha aktet e nevojshme, si edhe te ndjeke procedurat perkatese prane Autoritetit kontraktor, apo perpara personave te trete fizike apo juridike, te nevojshme per realizimin e objektit te sipermendur.

Perfaqesimi shoqerise kundrejt paleve te treta, ne perputhje me dispozitat e kesaj kontrate, dhe/ose te ligjit te zbatueshem i perket Administratorit te vetem te Joint Veture, Z.Elian Shena, i cili ka te drejte te veproje me nenshkrim te vetem te cdo lloj akti pa kufizim.

Per kryerjen e veprimeve te caktuara, Administratori do te kete te drejten e autorizmit te personave te trete.

## Neni 4
## Kohezgjatja e kontrates

Kjo kontrate eshte e vlefshme deri ne permbushjen dhe arritjen e kryerjes se punimeve te ndertimit te objektit "Per ndertimin e impiantit gjenerues te energjise elektrike fotovoltaike me kapacitet te intaluar 2MW,dhe veprave ndihmese,ne Zonen Grykë,Bashkia Fier,Qarku Fier.

Ne momentin e arritjes se qellimit objekt kontrate, asnje nga palet nuk do te jete e lidhur me parashikimet e kesaj kontrate.

## Neni 5
## Pjesmarrja

**Pjesmarrja ne zbatimin e kontrates, do te jete e perbashket, e shprehur ne perqindjet :**

| | |
|---|---|
| **Shoqeria 2B 1979** | **50 %** |
| **Shoqeria 2T shpk** | **50 %** |

Shoqerite ne bashkepunim me njera tjetren, marrin persiper qe ne kuadrin e pjesmarrjes ne proceduren e lartpermendur te permbushin keto detyrime: Per realizimin e projektit shoqeria 2T shpk do te realizoje 50% te punimeve dhe shoqeria 2B 1979 do te kryeje 50% te punimeve. Mjetet financiare do te vendosen bashkerisht nga shoqerite e mesiperme duke respektuar perqindjet e siperpermendura.

A2023053240061749832

Shoqeria 2T shpk do te faturoje 50% te punimeve shoqerise 2B 1979

**Neni 6**
**Ndarja e fitimit**

**Ndarja e Fitimit do te jete e perbashket, e shprehur ne perqindjet :**

**Shoqeria 2B 1979** **50 %**

**Shoqeria 2T shpk** **50 %**

**Neni 7**
**Shpenzimet**

Shpenzimet per garancine e kontrates, si dhe te gjitha garancive te tjera te kerkuara do te perballohen ne menyre te perbashket, sipas perqindjeve te percaktuara ne pjesmarrjen e ketij grupi ne cdo pale.

Palet do te jene pergjegjese dhe do te perballojne shpenzimet qe rrjedhin nga detyrimet kontraktuale bashkerisht.

**Neni 8**
**Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Mosmarreveshjet qe lindin mes paleve do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**Dispozitat Përfundimtare**

Kontrata u lexua nga unë Noteri/ja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri/ja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALET**

**2T shpk**
**Administrator**
**Artan Sako**

Artan Sako

NDERTIME, CIVILE, INDUSTRIALE 2T Sh.p.k. NIPT K01731001M Ndertim - Projektim TIRANE - ALBANIA

**2B 1979 shpk**
**Administrator**
**Bledar Broshka**

Bledar BROSHKA

2B 1979 L91508021H Tirane - Albania

NOTER
RIDVANA G. RUÇI